



- Kudo, kurdoherë, për këdo
- Mësimnxënie e personalizuar
- Bashkëpunim dhe ndërveprim

Mbi **8000** përdorues nga **58** institucione të ndryshme



Numri i përdoruesve aktivë në MësoVET ka pësuar rritje nga viti në vit (nga 285 në vitin 2019 në **7461** përdorues aktivë në 2021)



Për të asistuar përdoruesit në navigim dhe mësuesit në zhvillimin e materialeve digjitale janë realizuar rreth **50 video tutoriale** dhe **7 kurse udhëzuese** të ngarkuara në platformë dhe në kanalën e MësoVET në YouTube

Një zgjidhje praktike për mësuesit dhe nxënësit!

MësoVET është një platformë mësimore digjitale e krijuar për të siguruar mësuesit dhe nxënësit me një sistem të sigurt dhe të integruar për të zhvilluar mësimin e kombinuar.

Platforma u shërben **72%** të nxënësve në arsimin profesional. **65%** e përdoruesve të MësoVET janë nxënës e mësues të shkollave partnere të S4J.

MësoVET ofron **falas** materiale dhe kurse e module të **lëndëve profesionale e të përgjithshme** të cilat iu ofrojnë mësuesve gjithçka ata kanë nevojë për të nxitur **interaktivitet dhe ndërveprim** midis nxënësve.

Platforma i bën klasat më të arritshme, ofron një gamë të larmishme materialesh mësimore dhe tërheq një numër të gjerë nxënësish pavarësisht zonës gjeografike ku ndodhen. Shumica e materialeve mësimore në MësoVET **bazohet në kurrikulë**, por ka dhe **materiale praktike** të rekomanduara nga ekspertët e industrisë.

- [89 lëndë profesionale](#)
- [50 module](#)
- [33 lëndë të përgjithshme](#)
- [96 materiale mësimore \(libra\)](#)
- [8 programe trajnimi](#)

Kurset apo lëndët u përkasin **8 drejttimeve të AFP**.

Aty ofrohen mjetet më fleksibël për të mbështetur si **mësimin e kombinuar** ashtu edhe kurset 100% në internet dhe mbi të gjitha është **në gjuhën shqipe**.

S4J që në fillim të herës ka promovuar një **qasje të integruar të mënyrave të reja të nxënimit** ku qasja në teknologji është kombinuar me mbështetjen teknike të mësuesve, si një kusht i domosdoshëm i realizimit të procesit të të nxënimit. Platforma MësoVET është një pikë kyc e gjithë këtij procesi. Projekti ka kryer disa studime që demonstrojnë dhe **impaktin pozitiv që ka patur MësoVET në zhvillimin e një procesi mësimor cilësor**.